

FJALA E DEPUTETES KLOTILDA BUSHKA

E ENJTE 24 NËNTOR 2022

Të dashur qytetarë,

Sot është një ditë e bukur për Shqipërinë, dhe duke lënë mënjanë modestinë duhet të përgëzojmë qeverinë shqiptare, grupin negociator për arritjen e një marrëveshjeje të tillë, e cila përkthehet në investimin më të madh strategjik që Shqipëria ka marrë në këta 30 vjet. Bëhet fjalë jo vetëm për një investim, i cili do ta shndërrojë komplet Durrësin, duke e bërë një qendër të turizmit dhe një qendër shembull për të gjithë rajonin se si duhet të jenë standardet në turizëm, por për të gjithë Shqipërinë, sepse impakti që ka ky investim strategjik në aspektin ekonomik dhe social, është i tillë që ndikon në të gjithë ekonominë e Shqipërisë.

Thënë këtë, doja që sot të kishim diskutime konstruktive, të cilat informojnë qytetarët se përse bëhet fjalë, sepse ju dëgjoj, kolegë të opozitës, të thoni: “S’jemi kundër investimeve të huaja, por ju duhet të hidhni dritë”. Në fakt, ju s’po hidhni dritë, por po hidhni baltë. Ju po bëni tymnajë për gjëra, të cilat nëse i marrim fjalë për fjalë, e lexojmë të zezën mbi të bardhë në aktet që ne kemi studiuar, shqyrtuar në komision dhe të cilat do t’i miratojmë sot, janë të sakta, të thjeshta. E vërteta është se kontrata që ne miratojmë sot (që, në fakt, është një marrëveshje me një sërë aneksesh që janë, gjithashtu, dokumente shumë të rëndësishme), për mua si juriste me mbi 20 vjet eksperiencë, është pa dyshim më e mira që shteti shqiptar ka lidhur ndonjëherë; është një kontratë që më së miri adreson interesin e popullit shqiptar, interesin e Shqipërisë në bashkërendim me një investim serioz, strategjik si ky që po diskutojmë sot.

Këtu bëhet fjalë për transformimin e Durrësit, bëhet fjalë për krijimin e një porti shumë të rëndësishëm, i cili do të konkurrojë për nga rëndësia dhe për nga cilësia me porte të tjera të rëndësishme që kanë treguar në vende të tjera se e kanë kthyer qytetin dhe shtetin përkatës në qendër të rëndësishme zhvillimi. Këtu bëhet fjalë për ndërtimin e hoteleve, patjetër, edhe të rezidencave. Këtu bëhet fjalë për krijimin, dhe jo pak, të 700 metra linear gjatësi plazhi në Durrës, i cili sot nuk është dhe do të jetë për publikun. Mijëra hektarë pasuri publike do të kthehen në hapësira për qytetarët. Bëhet fjalë për 2 miliardë e 1 milion euro investime, të cilat nuk vijnë nga shteti shqiptar, sepse shteti shqiptar hedh zero

para në këtë investim, por vijnë nga një investim strategjik, nga një investitor strategjik, për të cilin sot ju, për të thënë të drejtën, bëtë shumë komente raciste dhe me të cilat nuk jam aspak dakord.

Keni ngritur dhe keni ulur sot një investim dhe një investitor serioz, të cilin e vlerësojnë në Amerikë, e vlerësojnë në Europë, e vlerësojnë në shumë vende të tjera të botës, dhe këtu, në Shqipëri, opozita jonë qenka skeptike. Nuk keni pse të jeni skeptikë, duhet të kishit parë kontratën dhe të kishit bërë sugjerime për çfarë duhej të përmirësohej. Ndërkohë, e lexuat, e studiuat kontratën, e kthyet nga poshtë-lart, nga lartposhtë, por nuk gjetët asgjë. Dhe çfarë ju ngeli? Ju ngeli të bëni atë që dini të bëni gjithmonë, të bëni tymnajë. Tani, për t'ua shpjeguar gjithë qytetarëve, ju abuzoni me faktin që këtu s'po bëhet garë dhe se investitori është zgjedhur në mënyrë abuzive.

Në radhë të parë, në Shqipëri çdo punë e qeverisë bëhet sipas ligjeve që i kemi miratuar këtu. Ligji për turizmin dhe ligji për investimet strategjike për investime të tilla, për sigurinë juridike dhe për rëndësinë që ka projekti, parashikojnë specifikisht që projekti të jetë i gjatë, të jetë eficient dhe të sjellë ato rezultate që priten sipas biznesplanit. Ju dëgjoj këtu të bëni shumëzime dhe pjesëtime, a thua se jeni të gjithë biznesmenë. Por ka një biznesplan të bashkëngjitur marrëveshjes, ku jua thotë shumë qartë sesi janë të ardhurat e pritshme. Ato analizojini, mos bëni shumëzime dhe pjesëtime këtu, se nuk i keni edhe këto aftësi, tek e fundit. Të gjitha këto janë të parashikuara qartë në ligj.

Në ligjin për turizmin thuhet qartë: "Parashikohet një investim strategjik kur shteti shqiptar i ka dhënë rëndësi nëpërmjet një legjislacioni tjetër, siç është ai i investimeve strategjike, të bëhet me ligj të posaçëm". Ne ku t'i gjejmë investitorët si i suksesshmi Alabaar, të vijnë sa më shumë në Shqipëri, pasi në 30 vjet nuk kemi parë një investitor që të vijë dhe të marrë riskun përsipër, duke investuar paratë e veta, për të bërë një investim të tillë, që i shërben Shqipërisë (se që ky projekt i shërben Shqipërisë, nuk e mohoni dot) dhe ne të mos e pranim. Patjetër, Shqipëria është e hapur për të pritur investime të tilla, por në 30 vjet ky është investimi më i madh që kemi pasur ndonjëherë.

Ky projekt është sa dyfishi i TAP-it. Është një investim i përhershëm, ndryshe nga TAP-i që ishte i përkohshëm. Është një investim që siguron punë për 12 mijë njerëz, përveç gjenerimit të të ardhurave e të tjera, sepse kanë folur kolegët dhe nuk dua t'i përsëris. Çështja në të cilën dua të ndaloj është kontributi i shtetit shqiptar. Përveç aftësive negociuese të qeverisë shqiptare, e cila ka bërë një kontratë model dhe unë mendoj se është një nga kontratat më të mira që kemi pasur ndonjëherë në këtë fushë, përveç se është një investim unik dhe kaq strategjik, është e qartë se çfarë jep. Çfarë jep qeveria shqiptare? Jua kam thënë edhe në komision kur kemi diskutuar, nuk po flasim për një projekt bamirësie,

por po flasim për një projekt që është investim strategjik dhe do të duhet të përputhim interesin më të lartë të qytetarëve shqiptarë me një investim strategjik, që pa diskutim do të bëhet me një investitor privat, se janë pak edhe në botë, nuk janë pafundësisht.

Kështu siç flisni ju, duket sikur çdo ditë do të mund t'i bënim këto investime, por në fakt, jo. Na ka rënë fati sot, është edhe aftësia e qeverisë shqiptare, që në këtë ditë sot, të jemi këtu duke diskutuar për këtë marrëveshje kaq të rëndësishme. Për të gjithë qytetarët: shteti shqiptar do të krijojë një shoqëri 100% në pronësinë e vet, e cila do të krijohet nga Autoriteti Portual i Durrësit. Pikërisht kjo shoqëri do të ketë në pronësi të gjithë tokën publike, të gjithë pronën publike, e cila do të vihet në dispozicion të projektit. Investitori strategjik nuk do të marrë në pronësi asnjë metër katror tokë publike, por kjo shoqëri 100% me kapital shtetëror, që krijohet nga Autoriteti Portual i Durrësit, do të bashkohet me shoqërinë e investitorit strategjik "Eagle Hills", e cila zotërohet po nga zotëria Alabaar dhe së bashku do të krijojnë një kompani të re.

Këtë thotë marrëveshja që po diskutojmë dhe që do ta votojmë sot. Kjo shoqëri e përbashkët, që do të jetë midis shtetit dhe privatit, do të ketë në kapitalin e vet 33% zotërim nga shteti shqiptar dhe 67% investitori i huaj. Për shqiptarët, se ju e dini, por nuk doni ta pranoni, është pikërisht kjo shoqëri e re, që do të krijohet në bazë të marrëveshjes që ne miratojmë sot, e cila do të jetë zhvilluesja e projektit. Kjo shoqëri e re, ku shteti shqiptar ka 33% të aksioneve dhe investitori i huaj 67%, nuk do të marrë tokë në pronësi, por do të marrë tokë në përdorim. Tokën në pronësi e ka shoqëria tjetër, e cila është tërësisht, 100% me kapital shtetëror e vënë në dispozicion të shoqërisë së re për zhvillimin e projektit.

Shoqëria e re, ku shteti është ortak me 33%, nuk do të marrë tokë në pronësi derisa ky projekt në përfundim të afatit të vet 20-vjeçar të përfundojë, derisa të realizohen të gjitha ndërtime dhe të ketë një dokument që në kontratë quhet "certifikatë e përfundimit të punimeve". Kjo shpjegon pse projekti bëhet me faza, pikërisht për të garantuar që garancitë e dhëna në kontratë të realizohen në mënyrë të tillë që interesi publik të ruhet deri në fund. Po pse e përgëzoj unë grupin negociator për këtë punë kaq të mirë? Sepse ka arritur të konkludojë që në këtë shoqëri të përbashkët, edhe pse shteti shqiptar është ortak minoritar, të ketë të drejtën e vetos për operacionet më të rëndësishme. Cilat janë këto operacione? Një nga ato operacione ka të bëjë me pyetjen që bëni ju: "Me çfarë parash do të bëhet ky investim?".

Do të bëhet me paratë e investitorit të huaj nga kapitalet e veta, do të bëhet me financime nga bankat, nga institucionet financiare, por shtetit shqiptar do të ketë të drejtën e fjalës si ortaku i 33%-shit në

shoqërinë e përbashkët me të huajin dhe do të japë pëlqimin e tij nëse do të veprohet apo jo. Po ju jap një shembull, sepse janë jo pak, por mbi 33 veprime të shoqërisë së përbashkët, ku edhe pse shteti shqiptar është në minorancë, do të vendosë veton, sepse ortaku maxhoritar nuk do të vendosë për një vendimmarrje nëse nuk bie dakord edhe me shtetin shqiptar. Kjo është përgjegjësia e atij që qeveris, që të ruajë interesin publik. Këta janë mekanizma...

Mos flisni kot nga vendi! Ju i dini shumë mirë, se këto mekanizma në fushën e negocimit të kontratave janë më të vështirat për t'u arritur. Po, bravo i qoftë qeverisë shqiptare që ia ka dalë! Jo vetëm kaq, por në këshillin mbikëqyrës të shoqërisë së re do të ketë dy anëtarë, njëri është një zëvendës drejtor, me qëllim që të kontrollohet veprimtaria edhe në menaxhimin e përditshëm të shoqërisë. Po këto duhen thënë. Nuk jeni dakord? Këto nuk janë gjëra pozitive? Ju lutem tani, të vërtetat t'i themi! Dyshimet ngrijini, nuk po ju thotë njeri gjë, por argumentojeni.

Tjetra, që është e rëndësishme, thoni: "Përrjashtim nga taksat". Të dashur qytetarë, nuk ka përrjashtim nga tatimet dhe nga taksat. Shoqëria e përbashkët, ku shteti është 33% ortak me të huajin, që do të zhvillojë këtë projekt të rëndësishëm strategjik për Durrësin dhe për të gjithë Shqipërinë, do të hyjë në kapital me zero para, ama nuk mund t'i kërkojë vetes të paguajë taksën e ndërtimit, sepse është vetë shteti shqiptar që hyn në projekt pa asnjë investim sigurisht që do të bëjë një përrjashtim për investitorin e huaj. Ky është kontributi i shtetit në këtë projekt strategjik.

Ta mbaroj edhe unë fjalinë, siç ia latë edhe zotit Sula një fjali? E fundit, meqenëse edhe koha iku. E fundit, se kisha shumë për të thënë, por më duhej t'i sqaroja disa detaje, që këtu anashkalohen me qëllim. Në Planin e Përgjithshëm Kombëtar të Territorit "Shqipëria 2030", Planin e Integruar Ndërsektorial të Brezit Bregdetar, Planin Kombëtar Sektorial të Transportit Detar dhe Infrastrukturës Portuale, dokumente të miratuara nga qeveria shqiptare dhe të konsultuara me publikun, në zgjedhjet e viteve 2013, 2017, 2021 dhe në zgjedhjet lokale më të fundit, projekti i Durrësit ka qenë një angazhim dhe një premtim i maxhorancës socialiste. Sot këtë premtim ne po e bëjmë realitet pas një pune të gjatë, profesioniste, me përgjegjshmëri të lartë, dhe uroj që qytetarët e Durrësit, si dhe të gjithë qytetarët e Shqipërisë t'i gëzojnë sa më shpejt frytet e këtij projekti. Faleminderit!